

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË
VENDIM

Kërkesa nr. 48729/08
SHOQËRIA PËRPARIMI SHA dhe të Tjerë
kundër Shqipërisë
dhe 3 kërkesa të tjera
(sibih listën bashkëngjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 15 tetor 2024 si një Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *Kryetar,*

Darian Pavli,

Andreas Zünd, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

Duke mbajtur në konsideratë:

Kërkesat kundër Republikës së Shqipërisë depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga kërkuesit e listuar në tabelën bashkëlidhur (“kërkuesit”), në data të ndryshme cituar në të;

vendimin për të njoftuar mbi kërkesën – në lidhje me të drejtën e kërkuesve për të gëzuar paqësisht pasuritë e tyre, si edhe të drejtën e kompanive të kërkuesit të parë dhe të dytë për një gjykim të drejtë – Qeverinë shqiptare (“Qeveria”), fillimisht e përfaqësuar nga Agjenti i saj znj. A. Hicka, dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, si edhe për të shpallur të papranueshme pjesën e mbetur të kërkesave përcaktuar si një vendim i pjesshëm në tabelën bashkëlidhur;

Vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me një urdhër konfiskimi të lëshuar në procedurat penale kundër kërkuesit të tretë, ku pretendohet se ky urdhër konfiskimi kishte ndikim ndaj pasurisë së të gjithë kërkuesve. Ankesat u bënë në mbështetje të nenit 6 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1.

2. Pas një shpërthimi masiv që ndodhi në fabrikën e çmontimit të armëve në Gërdec, një fshat rreth tridhjetë kilometra nga Tirana, më 15 mars 2008, shpërthim që shkaktoi vdekjen e njëzet e gjashtë personave dhe lëndimin e rreth 300 njerëzve, si edhe shkatërrimin e konsiderueshëm të pasurive, u ndërmorën procese penale ndaj personave të tretë, duke përfshirë kërkuesin e tretë, Mihal Delijorgji, me akuzat për vrasjen dhe shkatërrimin e pasurisë me eksploziv, dhe ndaj kompanisë Albdemil sh.p.k., që kishte bërë çmontimin e municionit në fabrikën e Gërdecit, tek e cila kërkuesi i tretë ishte menaxher.

3. Në këto procedura penale, Shteti dorëzoi një padi civile nëpërmjet së cilës të paditurit i kërkohet një dëmshpërblim në shumën prej 2,243,843,616 lekë (ALL) (rreth 21,050,000 euro (EUR) në atë periudhë). Në atë moment, disa prej viktimave në incidentin e Gërdecit tashmë ishin kompensuar nga fondi i rezervave të Këshillit të Ministrave, si edhe buxheti i fondit të kontingjentit të shtetit.

4. Për ta siguruar padinë, në mbështetje të kërkesës së prokurorisë, më 22 mars 2008, Gjykata e Rrethit Tiranë lëshoi një urdhër suestroje, si masë e përkohshme, me pretendimin se mbulohej pasuria e të gjithë kërkuesve. Urdhri i konfiskimit kishte të bënte, midis të tjerash, me llogaritë bankare dhe pasuritë e paluajtshme të kërkuesit të tretë. Efekti i atij urdhri ishte i tillë që kërkuesit të vazhdonin të ishin pronarë dhe në zotërim të pasurisë së tyre, por nuk iu lejohej që ta shisnin atë.

5. Kërkuesit depozituan apelime, rekurs në Gjykatën e Lartë dhe ankesa kushtetuese, ku kundërshtonin ligjshmërinë dhe justifikimin e urdhrit të konfiskimit. Veçanërisht, kompanitë e kërkuesit të parë dhe të dytë u ankuan se vendimi i Gjykatës së Rrethit kishte cenuar të drejtat e tyre ndaj pasurisë, ishte i barasvlershëm me ndalimin e operimit të biznesit të tyre dhe do të çonte në falimentimin e tyre. Kërkuesja e tretë argumentoi se shumica e pasurive të konfiskuara nuk kishin lidhje me Albdemil sh.p.k. Kërkuesja e tretë parashtrroi se nuk kishte lidhje midis pasurisë së saj dhe proceseve ndaj kërkuesit të tretë. Kërkuesi i katërt argumentoi se ai nuk kishte lidhje me aktivitetet e biznesit të Albdemil sh.p.k. dhe se kërkuesja e tretë nuk kishte pjesë në shtëpinë e tij. Pra, të gjithë kërkuesit kërkuan që të ndryshohej vendimi i Gjykatës së Rrethit në mënyrë që të përjashtoheshin pasuritë që nuk kishin lidhje me Albdemil sh.p.k.

6. Më 17 prill 2008, Gjykata e Apelit Tiranë i rrëzoi të gjitha ankesat, duke argumentuar se çështja që adresohet e lejonte ligjërisht masën e sekuestros, dhe arriti në përfundimin se urdhri i sekuestros ishte i ligjshëm. Vendimi përfundimtar u mor nga Gjykata Kushtetuese më 26 dhjetor 2008. Në këtë vendim argumentohet se vendimet e gjykatave të brendshme kishin të bënin me një masë të përkohshme dhe jo me një vendim mbi meritat e çështjes.

7. Më 12 prill 2012, kompania e kërkuesit të parë depozitoi një padi civile pranë Gjykatës së rrethit Durrës ndaj Prokurorisë së Tiranës dhe kërkuesit të tretë, Mihal Delijorgji, duke kërkuar që pjesa e pasurisë së saj të konfiskuar të përjashtohet nga urdhri i konfiskimit. Ajo u mbështet në nenin 12 të Kodit të Procedurës Civile (shih paragrafin 12 më poshtë).

8. Më 12 qershor 2012, Gjykata e Rrethit Durrës pranoi padinë me argumentin se pasuria në fjalë zotërohej nga kompania e kërkuesit të parë dhe nuk kishte lidhje me kërkuesin e tretë. Nuk u depozitua asnjë apelim, dhe vendimi u bë i formës së prerë.

9. Më 14 shkurt 2013, pas dënimit të kërkuesit të tretë, urdhri i sekuestros u hoq.

LIGJI I BRENDSHËM PËRKATËS

A. Kodi i Procedurës Penale (“KPP”)

10. Neni 270 §§ 1 i KPP-së e autorizon prokurorin të sekuestrojë pasuritë e të paditurit dhe çdo kursim apo pronë tjetër në zotërimin e tij, për aq sa parashikon ligji për një sekuestrim të tillë, në rastin kur “ka arsye të bazuara për të menduar se nuk ka garanci për pagimin e dënimit me gjobë, të shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit, prokurori kërkon sekuestron konservative të pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme të të pandehurit ose të shumave a sendeve që të tjerët i detyrohen atij, në caqet që ligji lejon sekuestrimin e tyre”.

11. Neni 273 parashikon se ekzekutimi i çdo urdhri në lidhje me sekuestrimin e pronës ekzekutohet në mbështetje të parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

B. Kodi i Procedurës Civile

12. Kodi i Procedurës Civile (“KPC”), në kapitullin IX për “Mjetet për ekzekutimin e vendimeve [dhe titujt ekzekutues]” përfshin si në vijim:

Neni 529

Sendet mbi të cilat nuk mund të vihet sekuestroja

“Përjashtohen nga sekuestrimi i pasurisë së debitorit:

1. sendet e përdorimit personal të debitorit dhe të familjes së tij si: veshjet, shtresat, mbulesat, mobiliet për aq sa ato janë të nevojshme për jetesën e tyre;

2. ushqimet dhe lëndët djegëse që i nevojiten debitorit dhe familjes së tij për tre muaj;

...

8. artikujt të tjerë të nevojshëm për jetesë.”

Neni 612

Padia për kërkimin e sendit nga personi i tretë

“Çdo person i tretë që pretendon se është pronar i sendit mbi të cilin bëhet ekzekutimi, mund të ngrejë padi për të ushtruar të drejtën e tij dhe kur është rasti për të përjashtuar sendin nga sekuestrimi dhe shitja. Padia ngrihet kundër kreditorit dhe debitorit në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit. Në këto raste, gjykata mund të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e ekzekutimit me ose pa garanci.”

C. Ligji nr. 8510 i datës 15 korrik 1999 për përgjegjësinë jokontraktuale të organeve të administratës Shtetërore

13. Neni 1 dhe 3 i atij ligji (ndryshuar me anë të ligjit nr. 10005 të datës 23 tetor 2008) parashikojnë se Shteti ka detyrim ndaj dëmit pasuror dhe jopasuror jokontraktual të shkaktuar ndaj personave fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj. Organet shtetërore kanë detyrimin të kompensojnë dëmin, midis të tjerash, kur, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre publike, veprimet ose mosveprimet e tyre të ligjshëm shkaktojnë dëmtim ndaj interesave të ligjshme të personave privatë fizik ose juridik.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Bashkimi i kërkesave

14. Sipas lëndës së ngjashme të kërkesave, Gjykata e gjykon të përshtatshme t’i shqyrtojë ato së bashku në një gjykim të vetëm.

B. Neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës

15. Kërkuesit, në mbështetje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, u ankuan se urdhri i sekuestros shkelte të drejtën e tyre për gëzim paqësor të pasurive të tyre. Kompanitë e kërkuesit të parë dhe të dytë iu referuan edhe nenit 6 të Konventës. Gjykata, si kompetente në përcaktimeve të bëra në ligj për faktet e çështjes, do të shqyrtojë kërkesat vetëm në mbështetje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës (krahaso *Ibrahimbeyov dhe të tjerë kundër Azerbajxhanit*, nr. 32380/13, § 39, 16 shkurt 2023, dhe *Zela kundër Shqipërisë*, nr. 33164/11, § 50, 11 qershor 2024).

16. Qeveria argumentoi se kërkuesit nuk kishin shteruar mjetet e disponueshme të brendshme, veçanërisht, një kërkesë për heqjen e urdhrin të sekuestros, një padi civile bërë në mbështetje të nenit 612 të Kodit të Procedurës Civile dhe një padi civile për kompensimin e çdo dëmi që kërkuesit mund të kishin vuajtur si pasojë e urdhrin të sekuestros.

17. Kërkuesit argumentuan se ata i kishin shteruar masat në kontekstin e procedurave gjatë të cilave ishte lëshuar urdhri të sekuestros, dhe se nuk iu ishte kërkuar të shteronin mjete të tjera. Gjithashtu, ata argumentuan se mjetet e ofruara nga Qeveria nuk ishin efektive.

18. Parimet e përgjithshme për shterimin e mjeteve të brendshme janë përmbledhur në vendimin *Vučković dhe të tjerë kundër Serbisë* ([DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §§ 69-77, 25 mars 2014), dhe *Gherghina kundër Rumanisë* ((vendim) [DHM], nr. 42219/07, §§ 83-89, 9 korrik 2015).

19. Gjykata ka gjykuar, veçanërisht, se në rast se ekzistojnë një sërë mjtesh vendase në fusha të ndryshme të ligjit që mund të ndiqen nga një individ, ky person ka të drejtën të zgjedhë një mjet që adreson ankesa thelbësore të tij ose të saj. Me fjalë të tjera, kur një mjet është ndjekur, nuk nevojitet përdorimi i një mjeti tjetër që në thelb ka të njëjtin objektiv (shih *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë* [DHM], nr. 41720/13, § 177, 25 qershor 2019). Sipas rrethanave, Gjykata duhet të vendosë në lidhje me çështjen konkrete nëse mjetet e përdorura nga kërkuesit në kontekstin e procedurave me anë të të cilave është lëshuar urdhri i sekuestros, dhe mjetet e referuara nga Qeveria (shih paragrafin 16 më sipër), kishin në thelb të njëjtin objektiv në lidhje me ankesat e kërkuesve.

20. Gjykata vëren se qëllimi kryesor i mjeteve të përdorura nga kërkuesit në kontekstin e procedurave penale me anë të të cilave ishte lëshuar urdhri i sekuestros ishte në kundërshtim me ligjshmërinë e urdhrin fillestar të sekuestros (shih paragrafin 4 më sipër), dhe nëse çështja ishte shqyrtuar nga gjykatat vendase sipas atyre procedurave.

21. Në lidhje me një kërkesë për heqjen e urdhrin të sekuestros, qëllimi i saj është të rivlerësojë nëse ekzistojnë ende kushtet për mbajtjen e urdhrin me kalimin e kohës, dhe është një mjet shtesë që mund të përdoret në procedurat me anë të të cilave u lëshua urdhri i sekuestros.

22. Për sa i përket padisë bërë në mbështetje të nenit 612 të KPC-së, qëllimi i saj është tërësisht i ndryshëm nga mjetet kundër urdhrit të sekuestros si i tillë, pasi në këto procedura palët e treta mund të kërkojnë që pasuria e tyre të përjashtohet nga “urdhri i ekzekutimit”, që është i vlefshëm (shih paragrafin 12 më sipër).

23. Në lidhje me një padi civile ndaj Shtetit për kompensimin e dëmeve, ajo synon përfitimin e kompensimit monetar për çdo humbje financiare ose ndonjë humbje tjetër në dëm të kërkuarve si rezultat i urdhrit të sekuestros (paragrafi 13 më sipër).

24. Në vijim, mjetet e përdorura na kërkuarve nuk kanë të njëjtin qëllim me tre mjetet e referuara nga Qeveria. Gjykata duhet të vlerësojë nëse tre mjetet e përmendura më sipër mund të konsiderohen si mjete efektive për shkeljen e pretenduar në mbështetje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

C. Në lidhje me kërkuarve të parë, të dytë, të katërt dhe të pestë

25. Për sa ka të bëjë me padinë civile të bërë në mbështetje me nenin 612 të KPC-së, këto procedura përfshijnë domosdoshmërisht vlerësimin e padive të pronësisë dhe, duke qenë të një natyre civile, mund të përshtaten më mirë për të adresuar të gjitha çështjet përkatëse për të drejtat e pronësisë së një individi. Gjykata vëren se kompania e kërkuarve të parë e përdori këtë mjet me sukses në lidhje me disa prej pasurive të saj të sekuestruara (shih paragrafët 7 dhe 8 më sipër). Këto procedura u përfunduan brenda dy muajve.

26. Rezulton se padia civile e bërë në mbështetje të nenit 612 të KPC ishte një mjet i disponueshëm dhe efektiv për ankesat sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 paraqitur nga kërkuarve i parë, i dytë, i katërt dhe i pestë. Megjithatë, vetëm kompania e kërkuarve të parë e përdori atë mjet, dhe më pas, në mënyrë të pashpjegueshme, vetëm për pjesën e pasurive të saj. Kërkuarve i dytë, i katërt dhe i pestë nuk e përdorën atë mjet. Ata nuk kanë parashtruar se mjeti i ofruar nga Qeveria ishte për disa arsye të papërshtatshëm dhe joefektiv në rrethanat konkrete të çështjes, dhe as se ekzistonin rrethana të posaçme që linin të lirë nga kërkesa për ta shteruar atë.

27. Sipas rrethanave, këto ankesa duhet të kundërshtohen në mbështetje të nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshkrim të mjeteve vendase për kërkuarve të parë, të dytë, të katërt dhe të pestë.

D. Në lidhje me kërkuarve të tretë

1. Për sa i përket urdhrit fillestar të sekuestros

28. Gjykata vëren se urdhri i sekuestros u lëshua në kontekstin e procedimeve penale ndaj kërkuarve të tretë. Sekuestrimi i pronës në rrethana të tilla normalisht ka lidhje me kontrollin e përdorimit të pronës, që i përket paragrafit të dytë të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës. Gjykata duhet të gjykojë nëse kjo masë ishte e ligjshme dhe “në përputhje me interesin e përgjithshëm”, dhe nëse ekzistonte një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që pritej të përmbushej (shih *Džinić kundër Kroacisë*, nr. 38359/13, §§ 60 dhe 62, 17 maj 2016, dhe çështjeve cituara në të).

29. Sekuestrimi i pronës së kërkuarve të tretë u mbështet në nenin 270 § 1 të KPC-së (shih paragrafin 10 më sipër), dhe për këtë arsye ishte i ligjshëm.

30. Gjithashtu, Gjykata pranon se ndërhyrja ndiqte një qëllim legjitim, më konkretisht sigurimin se do të shlyhej detyrimi ndaj Shtetit.

31. Në lidhje me proporcionalitetin e masës, kërkuarve i tretë akuzohej në procedurat penale me anë të të cilave urdhërohej sekuestrimi. Në këto procedura, Shteti depozitoi një padi për rimbursimin e fondeve që kishte shpenzuar për të ndihmuar viktimat e incidentit të Gërdecit. Duke pasur parasysh përmasat e konsiderueshme të padisë (shih paragrafin 3 më sipër), Gjykata e gjykon të arsyeshme që llogaritë bankare dhe pasuritë e paluajtshme të kërkuarve të tretë kishin qenë subjekt i urdhrit të sekuestros, i cili shërbente për të siguruar padinë e Shtetit ndaj tij.

32. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren se qëllimi dhe efekti i urdhrit të konfiskimit nuk ishte privimi i kërkuarit të tretë nga prona e tij. Ai vazhdon të ishte pronari i saj dhe të gëzonte zotërimin e saj. I vetmi kufizim ishte se atij nuk i lejohej ta shiste atë.

33. Gjithashtu, Gjykata vëren se jo e gjithë prona e kërkuarit të tretë ishte subjekt i urdhrit të sekuestros, pasi, sipas nenit 529 të KPC-së, një sërë njësisish, si për shembull njësitë që shërbenin për nevoja të përditshme dhe përdorim personal të debitorit janë përjashtuar nga sekuestrimi (shih paragrafin 12 më sipër).

34. Duke pasur në konsideratë të gjitha këto rrethana, Gjykata gjykon se urdhri i sekuestros lëshuar ndaj kërkuarit të tretë ishte proporcional.

35. Sipas rrethanave, ankesat e kërkuarit të tretë në lidhje me lëshimin fillestar të urdhrit të sekuestros ndaj tij janë qartazi të pabazuara në fakte dhe duhet të rrëzohen në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

2. Në lidhje me sekuestrimin e te zgjatur të pronës së kërkuarit të tretë

36. Gjykata vëren se me kalimin e kohës, kërkuari i tretë mund të kishte paraqitur një kërkesë për heqjen e urdhrit të sekuestros. Nëse do të kishte vepruar në këtë mënyrë, gjykatat e brendshme do të duhej të kishin vlerësuar nëse masa vijonte të ishte proporcionale dhe e nevojshme. Gjykata tashmë ka pranuar se një kërkesë e tillë është një mjet që duhet të shterohet në rrethanat kur sekuestrimi ishte në fuqi në periudha të zgjatura kohore, dhe në rastet kur kërkuarit argumentojnë se sekuestrimi ka humbur relevancën e tij me kalimin e kohës (krahaso *Džinić*, cituar më sipër, §48, dhe *BENet Praha, spol s.r.o. kundër Republikës së Çekisë*, nr. 33908/04, § 81, 24 shkurt 2011).

37. Në lidhje me dëmet e mundshme që mund të ketë vuajtur kërkuari i tretë për shkak të sekuestrimit të te zgjatur të pronës së tij, ai mund të kishte ndërmarrë një padi civile ndaj Shtetit, me qëllim përfitim të kompensimit financiar për të gjitha humbjet financiare apo humbje të tjera (krahaso *Fu Quan, s.r.o. kundër Republikës së Çekisë*, [DHM], nr. 24827.14, § 169, 1 qershor 2023, dhe *Zlatanov kundër Bullgarisë* (vendim), nr. 53050/21, §§ 184-85, 30 janar 2024). Një padi e tillë do të kishte qenë e mundur, në parim, sipas Kodit Civil dhe/ose sipas ligjit nr. 8510 (shih paragrafin 13 më sipër).

38. Në këtë kuadër, Gjykata vëren se kërkuari i tretë, në të vërtetë paraqiti përpara Gjykatës një padi, midis të tjerash, për dëmshpërblim monetar. Megjithatë, ai nuk e paraqiti një padi të tillë sipas parashikimeve përkatëse të ligjit vendas, ku gjykatat e brendshme do të caktoheshin për të vlerësuar proporcionalitetin e vijimit të urdhrit të sekuestros dhe/ose ta kompensonin për dëmet, në rastin kur do të kishin kapacitetin për të përzgjedhur dhe vlerësuar provat (shih *Joannou kundër Turqisë*, nr. 53240/14, § 98, 12 dhjetor 2017).

39. Në lidhje me dyshimet e kërkuarit të tretë për perspektivën e suksesit të mjeteve në fjalë, Gjykata ka theksuar se ekzistenca e dyshimeve në lidhje me perspektivën e suksesit të një mjeti të caktuar që është qartazi i dobishëm nuk është një arsye e vlefshme për mos ta shfrytëzuar atë. Një nga aspektet e kërkesës së shterimit është se në procedurat e brendshme kërkuarit duhet të bëjnë një përpjekje të arsyeshme për të përdorur mjetet procedurale që shërbejnë si parandalues ose mjete kompensuese, sipas rastit, për shkeljen e Konventës, duke përfshirë kërkesat provuese (shih *Vučković dhe të tjerë*, §§ 72 dhe 74, dhe *Zlatanov*, § 192, të dy cituar më sipër).

40. Sipas rrethanave, ankesat e kërkuarit të tretë në lidhje me sekuestrimin e zgjatur të pronës së tij duhet të kundërshtohet në mbështetje të nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshfrytëzim të mjeteve të brendshme.

E. Shkelje të tjera të pretenduara të Konventës

41. Kërkuarit të tretë dhe të katërt u ankuan se sekuestrimi joproporcional i pronës së tyre, i cili rezultoi në rënien e të ardhurave të tyre, kishte rrezikuar shëndetin dhe jetën e tyre në kundërshtim me nenin 3 dhe 8 të Konventës.

42. Gjykata vëren se kërkuessit e tretë dhe të katërt nuk shfrytëzuan mjetet e brendshme në lidhje me këtë ankesa. Në këtë mënyrë, këto ankesa duhet të kundërshtohen në mbështetje të nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshfrytëzim të mjeteve të brendshme.

43. Të gjithë kërkuessit u ankuan se nuk kishin një mjet efektiv sipas interpretimit të nenit 13 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të tyre të parashikuara në Konventë. Gjykata vëren se kërkuessit kishin mjete të brendshme në dispozicion që nuk i kishin ndjekur. Për këtë arsye, ankesat bërë në mbështetje të nenit 13 të Konventës duhet të deklarohen të papranueshme pasi janë qartazi të pabazuara, sipas nenit 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

Vendos t'i bashkojë kërkesat;

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 14 nëntor 2024.

Olga Chernishova **Ioannis Ktistakis**
Zëvendëssekretare Kryetar

SHTOJCË

Lista e çështjeve

Nr.	Emri i kërkuessit	Emri i çështjes	Kombësia e kërkuessit	Përfaqësuar nga
1	48729/08	Shoqëria Përparimi SHA kundër Shqipërisë	Shoqëria Përparimi sh.a. Shqiptar	Diana SYZIU
2	48740/08	Park Construction Albania sh.p.k. kundër Shqipërisë	Park Construction Albania sh.p.k. Shqiptar	Diana SYZIU
3	53694/08	Delijorgji kundër Shqipërisë	Mihal DELIJORGJI Shqiptar Vjollca DELIJORGJI Shqiptare	Diana SYZIU
4	54768/08	Delijorgji kundër Shqipërisë	Pandeli DELIJORGJI Shqiptar	Diana SYZIU